

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.
(II. ad Cor. III. 17).

**VOTER
KULTURE
SHOYPTARE**

3-7

Marc-Korrik 1939-XVII.

Vjeti XV.

S H K O D E R

Abonimi per „HYLLI I DRITËS“

Shqypni	Nji numer Fr. a. 0.80	Nji vjetë Fr. a. 7.—
Itali	„ „ „ „ 0.80	„ „ „ „ 7.—
Nder Vende tjera . .	„ „ „ „ 1.20	„ „ „ „ 10.—

Drejtori: Dr. A. Gj. Shllaku — Administratori: A. B. Dema

HYLLI I DRITËS

PERMBAJTJA

Dje e sod	fq. 145
Dr. E. ÇABEJ	
Për gjenezën e literaturës shqipe	» 149
GEGË TOSKA	
Fragment prej «Gomari i Babatasit»	» 181
ADOLPHE FERRIÈRE	
Bakule e vepra e tij edukatore	» 194
SPIRO KONDA	
Kritoni i Platonit	» 209
MUSTAFA KRÛJA	
Atë Gjergj Fishta Akademik	» 227
Telegramet qi i erdhen Shkelq. së Tij At Gjergj Fishtës	» 229
A. MARIN SIRDANI	
Toptanët në kryengritjen e 1912-s	» 231
BARDHYLI	
Suli	» 255
A. ANTON HARAPI	
Valë mbi valë	» 269

(vijon në fq. 3 të mblojcës)

Dje e sod

Kur u bâ Shqypnija, një shumicë e shqyptarëve u gëzue. Robnija e errsia e pësqindvjetëve na ndrroi ëmnat, por nuk muejti me na i ndrrue zëmbat.

Se e deshtem lirin, se punuem per liri, flasin lufta e Kosovës, luftat e Malcis së Madhe e të Dukagjinit, luftat e viseve të Jugut, flasin sá flamuj, sá libra, sá kangë, të cillat ngrohen, u dhane flakë zëmbave; flasin sá lot permallimi e gëzimi kur flamuri, i mshehun, i ruejtun me zili, pau një ditë driten e diellit; flet Karlo Suma, i cilli në mes jetës e dekës i kerkote me lot per faqe doktorit me i a zgjatue jeten deri sá të shihte symbolin e dishruem të kombit tuj value të lirë mbi Rozafë. Flet Dedë Gjo Luli, Qerqiz Topulli, Bajram Curri, Themistokli Germanji, Luigj Gurakuqi, Mustafa Qulli, e sá heroj tjerë.



U suell fleta e parë e historis s'onë së lumnueshme. Në fleten e dytë nisen me u regjistruer perpjekjet e nderimit. Si në çë do vend, porsá të lindun, bîjten ndertuesa, bîjten shkatrruesa. Urdija e hajdutve, e gjaksorëve, e trathtarëve grabiti, mbyti, shiti. Selija e të këqivet u vendue mbi shpinë të njëj populli fisnik. E tokë e zëmbra e vepra

